



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 5819 Prot.

Tiranë, më 7 / 11 / 2022

**URDHËR**

**NR. 593 , DATË 07 / 11 / 2022**

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 56, DATË 08.02.2021  
“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR MARRJEN NË DORËZIM TË REGJISTRAVE,  
AKTEVE NOTERIALE DHE VULËS TË TË NDJERËS ISH NOTERES TESHY BESHIRI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 67 paragrafi 2 dhe 72 paragrafet 1 dhe 3 , i ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018, “Për noterinë”, i ndryshuar, të VKM, nr. 304, datë 21.05.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)”, si dhe në urdhrin nr. 4, datë 07.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores për Administrimin dhe Përcaktimin e Roleve të Subjekteve që kanë të drejtë akses në bazën e të dhënave Shtetërore të Regjistrit Noterial Shqiptar”.

**URDHËROJ:**

- 1. Ndryshimin e pikës 1, germa “a,”b”, shtimin e germës “d” të Urdhrit nr. 56, datë 08.02.2021, si vijon:

Ngritja e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- a) Znj. Matilda Hoxha, Specialist në Sektorin e Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale;
- b) Znj. Diana Toro, Specialist në Sektorin e Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale;
- d) Znj. Albana Hoti, Anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë Tiranë.

- 2. Ndryshimin e pikës 4, të Urdhrit nr. 56, datë 08.02.2021, si vijon:

Arkiva merret në dorëzim me procesverbal dhe në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Degën Vendore të Noterisë Durrës.

- 3. Ndryshimin e pikës 5, të Urdhrit nr. 56, datë 08.02.2021, si vijon:

Arkiva t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noterës, znj. Diana Hoxha Malltezi, anëtare e Degës Vendore së Noterisë Durrës, pas verifikimit nga ana e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit, se noteri plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Ndryshimin e pikës 7, të Urdhrit nr. 56, datë 08.02.2021, si vijon:

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira në Ministrinë e Drejtësisë, të marri masat e nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës.

5. Shtimin e pikës 8 në Urdhrin 56, datë 08.02.2021, si vijon:

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori Arkiv – Protokollit të kryejë veprimet e nevojshme për të mbështetur kryerjen dhe marrjen në dorëzim të arkivit, për njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës.

6. Shtimin e pikës 9 në Urdhrin . 56, datë 08.02.2021, si vijon:

Ngarkohet Drejtoria TIK në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, për kthimin në statusin inaktiv nga Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH), të ish noteres, të ndjerës Tesy Beshiri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**ULSI MANJA**

